



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 3805 Prot
Shkodër, më 12.3.2019



YUNUS EMRE
ENSTITUSU

INSTITUTI "YUNUS EMRE"

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

PËR SHFAQJE ARTISTIKE

"18 Mars-Fitorja e Çanakalasë, Dita Përkujtimore e Dëshmorëve, Pranimi i Himnit Turk dhe Dita Përkujtimore e Mehmet Akif Ersoy"

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi lidhet ndërmjet:

Bashkisë Shkodër me seli ligjore Rr. "13 Dhjetori", Shkodër, përfaqësuar nga Znj. Voltana ADEMI në cilësinë e Titullarit të Institucionit,

dhe

Institutit «Yunus emre», me Status Ligjor: TD, Trup Diplomatik, me adresë kryesore: Rruga: Don Bosko, Nr. 6 Shkodër dhe me nr. Nipti: L52220451L, e përfaqësuar ligjërisht nga Zafer KIYICI

BAZA LIGJORE:

Ligji nr 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore"

Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar

VKB Nr 1, datë 22.01.2016 "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore ne Bashkinë Shkodër", i ndryshuar, pjesa II, pika 4,9.

OBJEKTI:

Bashkëpunim me qëllim zhvillimin e aktiviteteve kulturore në kuadër të promovimit dhe zhvillimit të artit, kulturës, turizmit dhe promovimit të territorit.

Duke qenë se:

Bashkia Shkodër ka prioritet mbështetjen dhe zhvillimin e aktiviteteve kulturore, nëpërmjet:

- ✓ Zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë.
- ✓ Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore me interes vendor.
- ✓ Organizimin e aktiviteteve kulturore dhe promovimin e identitetit kombëtar lokal si dhe zhvillimin e artit, kulturës, turizmit dhe promovimit të territorit.

Palët bien dakort sa mëposhtë:

QËLLIMI

Instituti «Yunus emre», ka si qëllim të sajën gjallërimin e jetës kulturore artistike. Ai zhvillon veprimtari të ndryshme kulturore.

Instituti, brenda muajit mars, do të vejë në skenën e Teatrit «Migjeni», shfaqjen artistike «18 Mars-Fitorja e Çanakalasë, Dita Përkujtimore e Dëshmorëve, Pranimi i Himnit Turk dhe Dita Përkujtimore e Mehmet Akif Ersoy», e cila shfaqet falas për publikun.

Realizimi i kësaj shfaqje, ka për qëllim të sjellë në sallën e Teatrit «Migjeni» kulturën dhe historinë turke.

Eksperienca shumë vjeçare e këtij Instituti, është garanci e padiskutueshme suksesi.

Aktiviteti realizohet në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër dhe Teatrin «Migjeni».

AFATI I MARRËVESHJES

Kjo marrëveshje bashkëpunimi lidhet nga palët me vullnetin e tyre të plotë dhe të lirë, me afat nga momenti i nënshkrimit të saj deri me datë 20.03.2019.

FORMA E BASHKËPUNIMIT

Realizimi nga ana e Insitutit «Yunus Emre», të aktivitetit «18 Mars-Fitorja e Çanakalasë, Dita Përkujtimore e Dëshmorëve, Pranimi i Himnit Turk dhe Dita Përkujtimore e Mehmet Akif Ersoy» në sallën e Teatrit «Migjeni», duke e ofruar atë falas për spektatorin shkodran. Promovimi i aktivitetit në media dhe në qytet përmes posterave, banerave etj, duke vënë në dukje bashkëpunimin me Bashkinë Shkodër.

Krijimi i kushteve të nevojshme nga ana e administratës së Bashkisë Shkodër dhe e Teatrit «Migjeni» për realizimin me sukses të këtij aktiviteti.

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al

KOMUNIKIMI

Çdo komunikim midis palëve do të bëhet me shkrim.

ZGJIDHJA E AKT MARRËVESHJES

Asnjëra nga palët nuk ka të drejtë të zgjidhë aktmarrëveshjen në mënyrë të njëanshme pa shkaqe të arsyeshme dhe para se të kenë njoftuar njëra - tjetrën me shkrim.

Palët bien dakort që çdo mosmarrëveshje apo kontraditë do të përpiqen t'i zgjidhin me mirëkuptim.

Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit, ato i drejtohen zgjidhjes së aktmarrëveshjes dhe procedurave juridike në fuqi, sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

DISPOZITA TË FUNDIT

Kjo akt marrëveshje do të quhet e vlefshme duke filluar nga data e nënshkrimit të saj nga palët.

Kjo aktmarrëveshje u hartua në tre kopje, nga të cilat njërën e merr Instituti « Yunus Emre », ndërsa dy të tjerat i mban Bashkia Shkodër.

PËR
BASHKINË SHKODËR

KRYETAR


Vullana Ademi

PËR
INSITUTIN "YUNUS EMRE"


Zafer KIYICI